

Më shumë se 50 shqiptar që kanë banuar në lagjen e Trimave në Kumanovë gjenden në stacionet policore në bisedë informative bëjnë të ditur informacione jozyrtare nga terreni, transmeton zhurnal.mk.

Në mesin e tyre gra, pleq dhe fëmijë.

Informacionet jozyrtare flasin se këta persona janë marrë nga policia në bisedë informative për kinse a kanë dijeni me grupin e armatosur që dje u përleshë me policinë maqedonase ku 5 pjestar të njësiveve speciale humbën jetën, ndërsa më shumë se 20 policë u plagosën.

Familjarët e këtyre mbi 50 personave kërkojnë ndihmë nga institucionet përgjegjëse dhe OSBE-ja që të dinë më shumë për fatin e tyre, pasi në mesin e tyre ka fëmijë , grad dhe pleq.